UDHËZIM
Nr.24, datë 16.7.2010

PËR PROCEDURAT E FALJES SË TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR QARKULLIMIN E AUTOMJETEVE TË HUAJA

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës dhe të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

1.Të gjitha detyrimet e prapambetura të tarifës së shërbimit për qarkullimin e automjeteve të huaja falen në bazë të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", të ndryshuar.

2.Në pikën e kalimit kufitar në dalje, pronarët e mjeteve me targa të huaja kryejnë veprimet e daljes pa paguar tarifën e shërbimit për qarkullimin e mjeteve të huaja.

3.Për rastet kur automjeti me targë të huaj, me akt noterial, kalon në pronësi të personave të tjerë të cilët më pas do ta pajisin me targë shqiptare sipas legjislacionit në fuqi, pronari i paraqet degës së doganës në momentin e zhdoganimit të automjetit vetëm dokumentet e zhdoganimit të mjetit duke mos pasur detyrimin e pagimit të detyrimeve të akumuluara për tarifën e shërbimit për qarkullimin e mjeteve të huaja.

4.Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për sistemin e detyrimeve të prapambetura të subjekteve debitorë për tarifën e shërbimit të qarkullimit të mjeteve të huaja.

5.Udhëzimi nr.30, datë 17.10.2008 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për qarkullimin e automjeteve të huaja", i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode